

### Përmbledhje

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik në TM4 2018 (rreth 1.2 përqind), përderisa inflacioni ka shënuar rritje dhe i është afruar objektivit të BQE-së. Përkundër ngadalësimit të rritjes së aktivitetit ekonomik në eurozonë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me rritje të përshpejtuar të aktivitetit ekonomik (3.9 përqind në TM3 2018 nga 3.3 përqind në TM3 2017).

Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM3 2018 shënoi rritje vjetore prej 3.5 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe konsumit ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM4 2018 nuk janë publikuar ende nga ASK-ja, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi dhe projeksionin tremujor të BQK-së, rritja ekonomike tremujore si dhe vjetore në TM4 2018 vlerësohet të ketë qenë më e lartë prej rreth 3.8 përqind. Vlerësimet për një rritje më të lartë tremujore mbështeten, përveç në rritjen e kërkesës së brendshme, edhe në ngadalësimin e rritjes së deficitit në komponentën e neto eksporteve si rezultat i rritjes më lartë të eksporteve dhe ngadalësimit të rritjes së importeve. Niveli i çmimeve të konsumit në ekonominë e vendit është rritur për 2.2 përqind në TM4 2018, pas rritjes më të ngadalshme me të cilën u karakterizuan në tremujorët paraprak.

Megjithatë, inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), rezultoi të jetë

për 1.4 pikë përqindje më i ulët në vetëm 0.8 përqind në TM4 2018, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të energjisë.

Spektori fiskal deri në nëntor 2018 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 4.4 përqind përkatësisht 13.0 përqind. Përkundër faktit se norma e rritjes së shpenzimeve ishte dukshëm më e lartë krahasuar me normën e rritjes së të hyrave, buxheti i Kosovës regjistroi deficit të ulët buxhetor prej 0.8 përqind e BPV-së. Borxhi publik në TM4 2018 ka arritur në 1.1 miliardë euro, që është për 9.7 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm përderisa borxhi i jashtëm publik u karakterizua me rënie. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 përqind nga 16.2 përqind sa ishte në TM4 2017.

Në TM4 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje vjetore të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 31.2 përqind. Si përqindje e BPV-së, deficitin në llogarinë rrjedhëse vlerësohet të ketë arritur në 14.5 përqind, nga 11.7 përqind sa ishte në TM4 2017. Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave si dhe zvogëlimit të suficitit të shërbimeve dhe të ardhurave parësore, përderisa bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje vjetore prej 3.6 përqind përkatësisht 46.4 përqind.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>04</b>
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare-----	06
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>07</b>
Sektori Real-----	07
Çmimet-----	09
Regjistri i bizneseve-----	10
Sektori Fiskal-----	11
Sektori i Jashtëm-----	12

## FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë-----	04
Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë-----	05
Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'-----	06
Figura 4. Çmimet e metaleve-----	06
Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	07
Figura 6. Treguesit e tërthortë për investimet private-----	07
Figura 7. Konsumi privat dhe burimet e financimit-----	08
Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	09
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	09
Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	09
Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit-----	10
Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	10
Figura 13. Regjistri i bizneseve-----	10
Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	11
Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave-----	12
Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	12
Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive-----	13
Figura 18. Remitencat-----	13
Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve-----	14
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së-----	05
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	16

## SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistike të Bashkimit Evropian (Eurostat), në vitin 2018 ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.8 përqind, që është një normë e rritjes më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak (2.4 përqind në 2017). Përveç tremujorit të parë kur u aktiviteti ekonomik u karakterizua me një rritje më të lartë prej 2.4 përqind, rritja ekonomike në tremujorët pasues rezultoi më e dobët duke zbritur në 1.2 përqind në TM4 2018 (figura 1).



Aktiviteti i ngadalësuar ekonomik i'u atribuua kryesisht ndikimit të dobësimit të tregtisë ndërkombëtare, ndikimit negativ të disa faktorëve të përkohshëm duke përfshirë kushtet e këqija atmosferike dhe zvogëlimi i prodhimit të makinave, si dhe ritmit shumë të fortë të rritjes në vitin 2017. Pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në periudhat në vazhdim nuk janë optimiste kryesisht si pasojë e rritjes së pasigurive lidhur me marrëdhëniet e ardhshme tregtare, të cilat mund të ndikojnë besueshmërinë e bizneseve. Kjo ka bërë që projeksionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) të sugjerojnë për një rritje


të ngadalësuar ekonomike në tre vitet e ardhshme (1.5 përqind në 2021).

Megjithë presionet më të dobëta inflacioniste në fillim të vitit 2018, ndryshimi i dinamikave gjatë vitit rezultoi në rritje të shkallës së inflacionit në 1.7 përqind në vitin 2018 (1.4 përqind sa ishte në vitin 2017). Në TM4 2018, mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë ishte 1.9 përqind (figura 1), që kryesisht i atribuohet rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimit.

Kontribut të rëndësishëm në rritjen e shkallës së inflacionit ka dhënë politika ekspansioniste monetare dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior. Në tetor të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka vendosur që programi mujor për blerjen e aseteve nga 30 miliardë euro të reduktohet në 15 miliardë euro dhe të vazhdojë deri në fund të vitit 2018 dhe më pas, varësisht nga zhvillimet në nivelin e çmimeve, blerja e aseteve të përfundojë. Në dhjetor të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka vendosur që të përmbysë programin për blerjen e aseteve si dhe ka paralajmëruar se ka për qëllim që të vazhdojë riinvestimin në pagesat e plota të principalit nga asetet që maturojnë (që janë blerë në kuadër të programit), për një periudhë të zgjatur kohe, për aq sa do të vlerësohet si e nevojshme për të siguruar kushte të favorshme të likuiditetit në treg. Parashikimi për shkallën vjetore të inflacionit për vitin 2019 është rreth 1.6 përqind, ndërsa prospektet për një ngadalësim të rritjes ekonomike kanë ndikuar që parashikimet për periudhën afatmesme të mos jenë edhe aq optimiste sa i përket arritjes së nivelit të përcaktuar me objektivat monetare.

Në anën tjetër, në dhjetor 2018, Këshilli Mbikëqyrës vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind). BQE-ja pritet të vazhdojë të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të refinancimit të pandryshuar edhe pas përfundimit të programit të lehtësimit sasior. Normat e kreditimit ndër-bankar Euribor 1 muhor dhe 12 muhor vazhdojnë të jenë në territor negativ (-0.37 përqind përkatësisht -0.14 përqind), ndërsa yield-i i obligacioneve qeveritare dhjetëvjeçare të eurozonës ka shënuar një rritje të lehtë gjatë TM4 2018, duke arritur në 1.39 përqind (figura 2).

Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë



Burimi: BQE (2019)

Aktiviteti kreditues në eurozonë ka vazhduar të rritet edhe në TM4 2018, rritje që është evidentuar si tek kreditë për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 2.8 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.0 përqind. Ngjashëm me ecurinë e kreditimit, janë zhvilluar edhe dinamikat e depozitave në sistemin bankar. Në TM4 2018,

depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.5 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.3 përqind.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë TM3 2018<sup>1</sup> ka shënuar rritje vjetore prej mesatarisht 3.9 përqind (3.3 përqind në TM3 2017). Mali i Zi dhe Shqipëria shënuan rritje më të lartë, pasuar nga Serbia, Kosova dhe Maqedonia (tabela 1).

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3
Bosnja dhe Hercegovina	-3.0	0.9	10.5	2.5	2.0	3.4	
Kosova	2.8	4.4	4.4	3.2	3.5	4.7	3.4
Mali i Zi	2.9	5.0	4.8	3.9	4.5	4.9	5.0
Maqedonia	0.0	-1.3	1.5	1.0	0.9	3.0	3.0
Serbia	1.6	1.8	2.2	2.5	4.8	4.9	3.8
Shqipëria	3.9	4.3	3.5	3.7	4.4	4.2	4.5

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistike të vendeve përkatëse

Në TM4 2018, inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar normë mesatare prej 1.7 përqind (2.1 përqind në TM4 2017). Normat më të ulëta të inflacionit ishin evidente kryesisht në Maqedoni (1.2 përqind), Shqipëri (1.5 përqind) dhe Mal të Zi (1.7 përqind), ndërsa në Kosovë, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë normat e inflacionit ishin më të larta prej rreth 2 përqind.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Në TM4 2018, norma mesatare e rritjes së kredive ishte 6.2 përqind (5.9 përqind në TM4 2017). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Kosova dhe Mali i Zi (11.2 përqind përkatësisht 9.2 përqind) ndërsa vendet tjera shënuan rritje më të ulët me përjashtim të Shqipërisë e cila raportoi për rënie të kreditimit prej

<sup>1</sup> Të dhënat për TM4 2018 nuk janë publikuar ende, ndërsa për Bosnje e Hercegovinë as për TM3 2018.


3.4 përqind. Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Në TM4 2018, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 10.0 përqind në nivel të rajonit. Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Maqedoni me 20.9 përqind, pasuar nga Serbia me 15.2 përqind, Bosnja e Hercegovina me 9.9 përqind, Kosova me 7.8 përqind, etj.

Gjatë TM4 2018, euro është vlerësuar ndaj lirës turke për 40.2 përqind ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit. Ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 3.1 përqind, ndaj frankës zvicerane për 2.3 përqind, ndaj lekut shqiptar 6.8 përqind, kunës kroate 1.5 përqind dhe dinarit serb për 0.6 përqind.

### Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Gjatë TM4 2018, çmimet e mallrave u goditën nga ngjarjet gjeopolitike dhe makroekonomike të cilat ndikuan në ndryshimin e dinamikave të ofertës dhe kërkesës në treg.

Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'




Burimi: Banka Botërore (2019)

Çmimet e energjisë shënuan rritje prej 11.5 përqind krahasuar me TM4 2017, kryesisht si përgjigje ndaj rivendosjes së sanksioneve ndaj Iranit nga Shtetet e

Bashkuara dhe rënies së vazhdueshme të prodhimit në Venezuelë. Çmimi i naftës së papërpunuar shënoi rritje prej 9.6 përqind krahasuar me TM4 2017. Çmimi i naftës *Brent* shënoi vlerën mesatare prej 64.3 dollarë për fuçi në TM4 2018 (58.7 dollarë për fuçi në TM4 2017). Në këtë rritje të çmimit të naftës ndikuan një sërë faktorësh, të cilët kanë rrezikuar eksportin e tij: zvogëlimi i stokeve si rezultat i rritjes së kërkesës botërore, marrëveshja e vendeve të OPEC-ut për të reduktuar ofertën e naftës, tensionet gjeopolitike në vendet e Lindjes së Mesme, etj. Ecuria e çmimeve të naftës në të ardhmen varet në mënyrë të konsiderueshme nga balanca ndërmjet prodhimit të naftës në SHBA dhe vazhdimësisë në uljen e prodhimit të naftës nga OPEC-u (figura 3).

Në anën tjetër, çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rënie prej 7.2 përqind krahasuar me TM4 2017, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënuan rënie prej 1.0 përqind (figura 4).

Figura 4. Çmimet e Metaleve



Burimi: Banka Botërore (2019)


Kjo rënie e çmimeve të metaleve erdhi si rezultat i zbutjes së kërkesës globale, forcimit të dollarit amerikan dhe rritjes së tensioneve tregtare midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Përkundër rënies në TM4, çmimet e metaleve ishin më të larta në vitin 2018

krahasuar me vitin 2017 si rezultat i rritjes së theksuar të çmimeve në gjysmën e parë të vitit 2018, ndërsa për vitin 2019 pritet të mbesin të pandryshuara. Në të ardhmen ekonomia e Kinës do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në tregjet globale të metaleve, duke qenë se përbën rreth 50% të konsumit të metaleve në nivel global. Kina pritet të reformojë procesin e sektorit të minierave dhe të përpunimit dhe të orientohet drejt një ekonomie të bazuar në konsum, gjë e cila do të ndikojë në rritje më të ngadaltë të kërkesës për metale.

Çmimi i arit ka shënuar rënie vjetore prej rreth 3.6 përqind në TM4 2018, duke regjistruar vlerën 1,228.8 dollarë për ons. Kjo rënie i atribuohet zvogëlimit të kërkesës për investim në kushtet e forcimit të dollarit amerikan dhe shtrëngimit të politikës monetare të disa prej ekonomive të zhvilluara, gjë që ka ulur atraktivitetin e arit si aset investues.

Edhe indeksi i çmimeve të ushqimit shënoj rënie prej 3.3 përqind krahasuar me TM4 2017. Gjatë vitit 2019 çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen, me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e shtrëngimit të ofertës së tyre.

Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK -së

## Ekonomia e Kosovës


### Sektori Real

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale përgjatë tre tremujorëve të vitit 2018 rezulton të ketë qenë rreth 3.9 përqind.

Përderisa gjysma e parë e vitit u karakterizua me përsheptim të rritjes ekonomike kundrejt vitit paraprak, në tremujorin e tretë është shënuar ngadalësim në 3.4 përqind. Kontribut kryesor në rritjen tremujore ekonomike kishin investimet me 6.8 pikë përqindje dhe konsumi me 5.0 pikë përqindje. Në anë tjetër, eksportet neto, si pasojë e rritjes së theksuar të importit por edhe rënies së eksportit, ndikuan negativisht në rritjen e BPV-së me -8.4 pikë përqindje (figura 5).

Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht rritjes së kredive për investime prej 6.4 përqind, rritjes së IHD-ve prej 41.0 përqind në TM3 2018 ndërkohë që edhe importi i mallrave kapitale shënoj rritje prej 25.1 përqind (figura 6).

Figura 6. Treguesit e tërthortë për investimet private




Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK-së

Konsumi privat ka kontribuar me 5.6 pikë përqindje (-5.7 pikë përqindje në TM3 2017). Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar

në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Remitencat dhe kompensimi i punëtorëve kanë shënuar rritje vjetore prej 4.8 përkatësisht 13.2 përqind në TM3 2018. Tregues tjetër i rritjes së konsumit privat në TM3 2018 është edhe rritja e importit të mallrave të konsumit, që shënoi rritje prej 3.4 përqind (figura 7). Përveç rritjes së konsumit privat, edhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë kanë shënuar rritje prej 17.1 përqind në TM3 2018.

Figura 7. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritje të BQK-së

Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në TM3 2018 e kishin tregtia (2.2 pikë përqindje), ndërtimtaria (1.1 pikë përqindje) dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.6 pikë përqindje). Ndërsa, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë si dhe industria përpunuese shënuan kontribut negativ (0.2 pikë përqindje secila) në rritjen e BPV-së reale.

Edhe pse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale në TM4 2018 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi dhe projeksionet tremujore, BQK vlerëson se rritja ekonomike tremujore dhe vjetore në TM4 2018 ishte më e lartë (rreth 3.8 përqind). Pritjet e BQK-së për këtë rritje tremujore kryesisht mbështeten në

ndryshimin e dinamikave në sektorin e jashtëm gjatë muajve të fundit të vitit (rritjes së eksportit dhe ngadalësimit të rritjes së importit), por edhe rritjes së shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë.

Sa i përket konsumit, projeksionet e BQK-së sugjerojnë një rritje më të ngadalësuar krahasuar me tremujorin paraprak. Kredia e re për konsum shënoi rënie tremujore prej 9.9 përqind në TM4 2018, përderisa remitencat shënuan rritje prej 5.9 përqind në muajt tetor-nëntor 2018. Gjithashtu, pritjet për një rritje më të ngadalësuar tremujore të konsumit privat mbështeten edhe nga ngadalësimi i rritjes së importit të mallrave të konsumit prej 2.8 përqind në periudhën raportuese (3.4 përqind në tremujorin paraprak). Në anën tjetër, shpenzimet rrjedhëse të qeverisë të cilat shënuan rritje prej 10.2 përqind në muajt tetor-nëntor 2018 pritjet të zbusin efektet negative të ngadalësimit të konsumit privat në konsumin e përgjithshëm. Treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale pozitive në TM4 2018. Importi i mallrave kapitale si dhe kreditë e reja për investime kanë shënuar rritje prej rreth 20 përqind përkitazi. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korrigjuar me numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rritje prej 31.4 përqind në TM4 2018.

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2019 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2018, duke arritur normën prej 4.2 përqind (4.0 përqind në vitin 2018). Ky përmirësim i lehtë i atribuohet kryesisht pritjeve për një zvogëlim të kontributit negativ të eksporteve neto në aktivitetin ekonomik, por edhe stimulit të përforcuar fiskal dhe rritjes së kreditimit dhe remitencave, të cilat pritjet të




vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik.

### Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit në vitin 2018 ka shënuar normën mesatare prej 1.1 përqind. Gjysma e parë e vitit 2018 është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të çmimeve (0.3 përqind), ndërsa në gjysmën e dytë është shënuar rritje më e lartë e çmimeve. Vetëm në TM4 2018, norma mesatare e inflacionit ishte 2.2 përqind (figura 8).

Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2019)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM4 2018, me rritje u karakterizuan çmimet e transportit (6.3 përqind), pasuar nga çmimet e ushqimit (3.7 përqind), çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.0 përqind), dhe çmimet e restoranteve dhe hoteleve (2.4 përqind). Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (4.7 përqind), çmimet rekreacionit dhe kulturës (1.2 përqind), çmimet e mjeteve të komunikimit (0.5 përqind), çmimet e veshmbathjes (0.2 përqind), etj. (figura 9).

Meqenëse shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), inflacioni bazë që përjashton këto komponente rezultoi të jetë stabil (figura 8).


Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Në TM4 2018, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.8 përqind, për 1.4 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2019)

Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamika e lëvizjes së çmimeve në Kosovë ndikohet në masë të madhe edhe nga lëvizja e çmimeve

të importit. Indeksi i çmimeve të importit në TM3 2018 shënoj rritje prej 2.5 përqind (figura 10).

Në TM3 2018, çmimet e produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (21.9 përqind përkatësisht 2.2 përqind), ndërsa çmimet e produkteve bimore si dhe çmimet e letrës dhe artikujve të saj shënuan rënien më të lartë (14.2 përqind përkatësisht 7.3 përqind) (figura 11).


Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)

Indeksi i çmimeve të prodhimit në TM3 2018 u karakterizua me rritje vjetore prej 2.3 përqind.

Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2019)


Rritjen më të lartë të çmimeve e shënuan prodhimi i metaleve dhe prodhimi i drurit (18.0 përqind 10

përkatësisht 2.9 përqind), ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit dhe prodhimi i lëkurës (11.1 përqind përkatësisht 1.9 përqind) (figura 12).

### Regjistri i Bizneseve

Tregues i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real është edhe numri i bizneseve të reja të regjistruara. Për dallim nga viti 2017 që ishte karakterizuar numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara, në vitin 2018 janë regjistruar 9,805 ndërmarrje të reja apo 6.3 përqind më shumë krahasuar me vitin 2017. Gjithashtu, edhe numri i ndërmarrjeve të mbyllura ishte më i vogël, 1,426 sosh apo 12.1 përqind më pak krahasuar me vitin 2017. Vetëm në TM4 2018 janë regjistruar 2,401 ndërmarrje të reja apo 25.0 përqind më shumë krahasuar me TM4 2017 ndërsa janë mbyllur 444 ndërmarrje apo 2.8 përqind më shumë krahasuar me TM4 2017 (figura 13).

Figura 13. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2019)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 2,525 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimit me 1,109 ndërmarrje, hotelerisë me 988 ndërmarrje dhe ndërtimitarisë me 959 ndërmarrje

(figura 14). Krahasuar me vitin 2017, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit janë regjistruar 219 ndërmarrje më shumë, në sektorin e ndërtimit 120 ndërmarrje më shumë, në sektorin e tregtisë 63 ndërmarrje më shumë, etj. Ndërsa, sektorët që shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i bujqësisë (196 ndërmarrje më pak), transportit (38 ndërmarrje më pak), aktiviteteve financiare (26 ndërmarrje më pak), etj.

Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja



### **Sektori Fiskal**

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> deri në nëntor 2018 arritën vlerën neto prej 1.60 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 249.3 milionë euro (11.8 përqind

rritje), ndërsa të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 2.9 përqind dhe arritën vlerën prej 1.2 miliardë euro. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej vetëm 0.9 përqind dhe arritën vlerën prej 174.2 milionë euro.

Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve buxhetore<sup>3</sup>, ato arritën vlerën prej 1.66 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 13.0 përqind. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje prej 7.6 përqind dhe arritën vlerën prej 540.0 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 17.2 përqind dhe arritën vlerën prej 203.7 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 13.0 përqind dhe arritën vlerën prej 499.6 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 25.5 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 18.6 përqind dhe arritën vlerën 422.0 milionë euro. Rrjedhimisht, si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 57.2 milionë euro krahasuar me suficitin prej 65.9 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitin primar ishte 0.8 përqind.

Borxhi publik në fund të vitit 2018 ka arritur në 1.1 miliardë euro që është për 9.7 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 përqind nga 16.2 përqind sa

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

ishte në vitin 2017. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.8 përqind (i cili ka arritur në 676.6 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 1.4 përqind duke arritur në 416.1 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 38.1 përqind nga 42.4 përqind sa ishte në vitin 2017.

Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqind.


### Sektori i Jashtëm

Në TM4 2018, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka arritur në 255.6 milionë euro që është për 31.2 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2017. Si përqindje e BPV-së, deficitin në llogarinë rrjedhëse vlerësohet të ketë arritur në 14.5 përqind, nga 11.7 përqind sa ishte në TM4 2017. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve dhe të ardhurave parësore, ndërsa bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave<sup>4</sup> arriti vlerën prej 784.3 milionë euro në TM4 2018, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 përqind. Si përqindje e BPV-së, deficitin në llogarinë e mallrave vlerësohet se ketë arritur në rreth 44.5 përqind, që është nivel i ngjashëm me TM4 2017.

Përderisa tremujorët paraprak të vitit 2018 u karakterizuan me rënie të eksportit të mallrave, në TM4 2018 u shënuar rritje e theksuar e eksportit të mallrave dhe ngadalësim i rritjes së importit. Kjo dinamikë rezultoi në rritje të shkallës së mbulueshmërisë së importeve me eksporte në 11.6 përqind, nga 11.3 përqind në TM4 2017.


Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2019)

Në TM4 2018 eksportit i mallrave ka shënuar vlerën prej 102.5 milionë euro, që është për 9.5 përqind më shumë krahasuar me TM4 2017 (figura 15).

Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)


Rritja e eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori ishte më e theksuar tek metalet bazë, produktet e plastikës

<sup>4</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

dhe gomës, ushqimet e përgatitura si dhe perimet. Në anën tjetër, rënie shënoj eksporti i makinerive dhe pajisjeve mekanike, produkteve minerale, lëkurës dhe artikujve të lëkurës, etj. (figura 16).

Vlera e importit të mallrave në TM4 2018 ishte 886.8 milionë euro, që është për 6.8 përqind më e lartë krahasuar me TM4 2017. Rritje më e lartë u shënuar tek importi i produkteve minerale, tekstili dhe artikujt e tekstilit, metalet bazë, makineritë dhe pajisjet mekanike, etj. (figura 17).

Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2019)


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 71.1 milionë euro në TM4 2018, një rënie prej 4.9 përqind krahasuar me TM4 2017. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoj rritje vjetore prej 9.4 përqind, duke arritur në 219.7 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoj rritje prej 18.0 përqind dhe arriti në 148.6 milionë euro.

Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet tjera të biznesit shënuan rritjen më të lartë prej 23.8 përqind, ndërsa shërbimet e udhëtimit, që përbëjnë kategorinë kryesore të eksportit (54.3 përqind e gjithsej eksportit të shërbimeve në TM4 2018), shënuan rënie prej 3.8 përqind. Edhe tek importi i

shërbimeve, shërbimet tjera të biznesit shënuan rritjen më të lartë (47.2 përqind), pasuar nga shërbimet pensionale dhe të sigurimit (21.0 përqind), ndërsa shërbimet e udhëtimit si dhe shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit shënuan rënie (3.4 përqind përkatësisht 0.4 përqind).

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, në TM4 2018, shënoj vlerën prej 50.1 milionë euro, që paraqet një rënie prej 34.3 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje për 2.1 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan vlerën prej 212.5 milionë euro në TM4 2018, apo 3.6 përqind më shumë krahasuar me TM4 2017 (figura 18).

Figura 18. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.9 përkatësisht 21.3 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.5 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.


Llogaria financiare në TM4 2018 shënoj bilanc prej -149.7 milionë euro (-70.6 milionë euro në TM4 2017).

Detyrimet por edhe asetet shënuan nivel dukshëm më të ulët krahasuar me TM4 2017. Detyrimet shënuan vlerën prej 21.3 milionë euro apo 76.9 përqind më pak krahasuar me TM4 2017, ndërsa asetet shënuan vlerën prej -128.4 milionë euro (21.8 milionë euro në TM4 2017).

Në kuadër të detyrimeve, kategori kryesore është ajo e IHD-ve, e cila arriti vlerën prej 61.9 milionë euro duke shënuar rritje prej 46.4 përqind krahasuar me TM4 2017.

përqind më shumë krahasuar me TM4 2017. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në TM4 2018 (20.8 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 18.8 milionë euro, Shqipëria me 10.7 milionë euro, etj.

Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 57.8 milionë euro dhe shënoj rritje prej 68.8 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerë prej 4.1 milionë euro që është përgjysmë më pak krahasuar me TM4 2017 (figura 19).

Niveli më i lartë i IHD-ve u shënuar në sektorin e patundshmërisë (40.7 milionë euro), mirëpo krahasuar me TM4 2017 kishte rënie për 9.0 përqind. Sektori i dytë për nga rëndësia ishte ai i shërbimeve financiare ku niveli i IHD-ve ishte 19.5 milionë euro apo 1.1

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2019): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 25 TM4 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2017	2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	6,413.8	6,739.0
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.5%	1.1%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.5%	2.9%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,530.4	1,598.1
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,464.5	1,655.3
Bilanci primar (në milionë euro)	65.9	-57.2
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,907.9	6,322.9
prej të cilave: Bankat	3,869.8	4,183.9
Kredi	2,485.5	2,755.5
Depozita	3,094.5	3,364.6
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.8%	6.0%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.3%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.5%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-395.0	-575.0
prej të cilave: remitencat e pranuar	689.8	731.4
Llogaria financiare	-284.3	-287.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	255.4	231.7
Investimet portfolio, net	14.7	-79.9
Investimet tjera, net	-156.9	-104.5
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-78.6	-113.7
Asetet	4,774.8	5,001.4
Detyrimet	4,853.4	5,115.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,069.2	2,089.5
Borxhi i jashtëm privat	1,570.7	1,594.7
Borxhi i jashtëm publik	498.5	494.8

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV për vitin 2018 është vlerësim i BQK-së;

2/ MF (2019);

3/ BQK (2019).

\*Të dhënat për sektorin fiskal janë deri në nëntor ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në shtator.

